REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SARANDË

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE E KONTROLLIT
TË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Nr. 6591/1 prot. Sarandë, më 12.09.2025

Lënda: Kthim përgjigjeje.

[redacted]

Në përgjigje të kërkesës tuaj protokolluar me tonën nr. 6591 Prot datë 08.09.2025, kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion dokumenatcioni, si dhe në mbështetje të ligjit Nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", ju bëjmë me dije se:

1. Nenit 9, të ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative", i ndryshuar, ku citojmë, në vijim:
   "Organi publik ka detyrimin që gjatë përpunimit të ligjshëm e të drejtë të të dhënave personale, të të dhënave që lidhen me veprimtarinë tregtare ose profesionale, me të cilat njihet gjatë procedurës administrative dhe që mbrohen sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, të ndërmarrë masa lidhur me mbrojtjen, ruajtjen, mospërhapjen, si dhe konfidencialitetin e tyre."
2. Nenit 45, pika 3, të ligjit 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative", i ndryshuar, ku citojmë, në vijim:
   "Dokumentet që përmbajnë të dhëna personale, tregtare ose profesionale, mund të merren ose të përdoren nga të tretët vetëm me pëlqimin e individit, të cilit i përkasin këto të dhëna. Pëlqimi nuk kërkohet nëse dokumentet do të përdoren për qëllime të parashikuara në ligj ose akte nënligjore."
3. Nenit 6, të Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, ku citojmë, në vijim:
   "Të dhënat personale përpunohen: a) nëse subjekti i të dhënave personale ka dhënë pëlqimin; b) nëse përpunimi është thelbësor për përmbushjen e një kontrate, për të cilën subjekti i të dhënave është palë kontraktuese, apo për diskutime ose ndryshime të një projekti/kontrate me propozimin e subjektit të të dhënave; c) për të mbrojtur interesat jetikë të subjektit të të dhënave; ç) për përmbushjen e një detyrimi ligjor të kontrolluesit; d) për kryerjen e një detyre ligjore me interes publik ose ushtrimin e një kompetence të kontrolluesit ose të një pale të tretë, së cilës i janë përhapur të dhënat; dh) nëse është thelbësor për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave legjitime të kontrolluesit, marrësit apo personave të tjerë të interesuar. Por, në çdo rast, përpunimi i të dhënave personale nuk mund të jetë në kundërshtim të hapur me të drejtën e subjektit të të dhënave për mbrojtjen e jetës personale dhe private."

4. Nenit 17, pika 1, të ligjit 119/2014, "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, ku citojmë, në vijim:

"E drejta e informimit mund të kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit dëmton interesat e mëposhtëm: a) të drejtën për një jetë private; b) sekretin tregtar; c) të drejtën e autorit; ç) patentat.

Kufizimi i së drejtës së informimit, për shkak të interesave të parashikuar në shkronjat "a", "b", "c" dhe "ç", të kësaj pike, nuk zbatohet kur titullari i këtyre të drejtave ka dhënë vetë pëlqimin për dhënien e informacionit përkatës ."

Për sa më sipër cituar, Bashkia Sarandë nuk mund tju vë në dispozicion dokumentacionin e kërkuar. Dhënia e dokumentacionit mund të kryhet vetëm me Kërkesë/Vendim të Gjykatës kompetente, ose me miratimin e shprehur të personit të cilit i përket ky dokumentacion.

Ju faleminderit për bashkëpunimin.